



---

Prishtinë, 18 maj 2026

**Të nderuara Medie,  
Të nderuar Qytetarë,**

Fillimisht ju njoftoj se kjo konferencë e ftuar për media, është e para për vitin 2026, prandaj dëshiroj t'ju falënderoj për pjesëmarrje dhe gatishmërinë tuaj për tu informuar në lidhje me rezultatet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Siç ju kemi informuar përmes ftesës publike, në këtë Konferencë do të shpalosen rezultatet kryesore të punës sonë përgjatë vitit 2025, të reflektuara në Raportin Vjetor të Performancës së ZKA-së, të dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me 30 prill të këtij viti.

Gjithashtu, sot do të shpaloset realizimi i Planit Vjetor të Auditimit 2025/2026 deri më tani, përkatësisht gjetjet kryesore të 24 raporteve të auditimeve financiare dhe pajtueshmërisë, dhe auditimeve të performancës. Për shkak të rëndësisë specifike, me theks të veçantë do të flas për auditimin e performancës “Efikasiteti dhe Efektiviteti i grumbullimit të mbeturinave të amvisërisë në kryeqytet”.

Në përputhje me mandatin kushtetues dhe sipas kërkesave ligjore i kam dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor të Performancës (RVP) për vitin 2025.

Ky raport prezanton informata për performancën e përgjithshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) karshi detyrimeve dhe mandatit ligjor, si dhe reflekton rezultatet e punës së ZKA-së, progresin e arritur dhe sfidat përgjatë vitit të kaluar. Gjithashtu, në raport pasqyrohen zhvillimet institucionale, përdorimi i burimeve dhe aktivitetet e zhvilluara për ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Dëshiroj të theksoj se Plani Vjetor i Auditimit për sezonin 2024/2025 është realizuar plotësisht.

Gjatë vitit 2025 kemi kryer gjithsej 133 auditime, për të cilat ju kemi informuar në vazhdimësi përgjatë vitit 2025.

Gjatë kësaj periudhe është kryer gjithashtu monitorimi i zbatimit të rekomandimeve dhe janë shqyrtuar proceset e administrimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe burimeve njerëzore. Po ashtu, vëmendje e veçantë i është kushtuar komunikimit të brendshëm si dhe komunikimit dhe bashkëpunimit me palët e jashtme.

Cilësia e raportimit financiar në organizatat buxhetore në vitin 2024 ka vazhduar të mbetet nën nivelin e pritur. Nga 87 auditime, 46 rezultuan me keqdeklarime materiale dhe opinione të modifikuara, ndërsa vetëm 41 me opinione të pamodifikuara.

Edhe në aspektin e pajtueshmërisë me kornizën ligjore, gjendja është e njëjtë, pasi shumica e organizatave, veçanërisht komunat, kanë rezultuar me papajtueshmëri ligjore si rrjedhojë janë dhënë mendime jo të mira.

Situatë e ngjashme ishte edhe në ndërmarrjet publike për sa i përket raportimit financiar. Nga nëntë auditime të mbuluara nga ana jonë, vetëm Telekom ka marrë opinion të mirë, ndërsa tetë të tjerat kanë marrë opinione jo të mira, përfshirë edhe opinione të kundërta.

Auditimet e performancës, teknologjisë së informacionit dhe pajtueshmërisë kishin identifikuar mangësi të konsiderueshme në sektorë kyç publik. Problemet përfshijnë mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit në shërbime publike, dobësi në planifikimin e projekteve infrastrukturore, mangësi në mbrojtjen e konsumatorëve, qeverisje të dobët në ndërtim dhe zhvillim urban, si dhe menaxhim joefikas në energjinë e ripërtëritshme dhe prokurim publik. Gjithashtu, janë evidentuar dobësi në digjitalizim, siguri të informacionit dhe menaxhim të të dhënave, duke kërkuar përmirësime të konsiderueshme në qeverisje dhe llogaridhënie.

Në anën tjetër, për sa i përket zbatimit të rekomandimeve, mund të them se analizat tona kanë treguar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit mbetet i ulët, vetëm 37% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa e mbetur është në proces zbatimi ose nuk është zbatuar akoma.

Gjatë vitit 2025, ZKA-ja ka avancuar komunikimin me palët e jashtme, duke rritur transparencën dhe praninë e saj publike. Përmes konferencave për media, punëtorive dhe komunikimit të vazhdueshëm me institucionet, shoqërinë civile dhe partnerët, ka kontribuar në forcimin e prezencës institucionale dhe në thellimin e bashkëpunimit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2025 është zhvilluar përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe pavarësisht mosfunksionimit të rregullt të Kuvendit, ZKA-ja ka përmbushur obligimin e saj raportuese dhe i ka dorëzuar Kuvendit raportet dhe dokumentet tjera vjetore dhe periodike, duke respektuar të gjitha afatet ligjore dhe procedurat e përcaktuara me ligj. Megjithatë, mosfunksionimi i Kuvendit ka pasur për pasojë mos shqyrtimin e raporteve të auditimit e cila ka zbehur llogaridhënien në administrimin e shpenzimit të parasë publike.

Gjatë vitit 2025 kemi mbajtur: tri konferenca për media; pesë punëtori me mediat lokale në të gjitha regjionet e Kosovës; një punëtori me organizatat e shoqërisë civile për të diskutuar planin e auditimit të performancës; punëtori ndërkombëtare me përfaqësues nga shtatë Institucione Supreme të Auditimit nga vendet e Evropës, si dhe punëtori e ngjarje të tjera në nivel vendi e ndërkombëtar.

ZKA-ja është angazhuar në mënyrë aktive në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të nxitur bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh me institucionet homologe në nivel regional dhe global.

Përveç kësaj, gjatë këtij vitit si rezultat i rritjes së besueshmërisë ndaj punës tone, ZKA-ja ka pranuar 31 sinjalizime nga qytetarët, zyrtarë publik, organizata joqeveritare dhe palë tjera të interesit. Nga këto, 14 raste janë trajtuar në përputhje me metodologjinë e auditimit dhe me procedurat e vlerësimit të rrezikut të brendshëm dhe një pjesë e tyre kanë rezultuar me gjetje të rëndësishme. 17 rastet e mbetura do të trajtohen gjatë vitit 2026 pasi natyra e tyre lidhet drejtpërdrejtë me planin e auditimit për sezonin auditues 2025-2026 i cili është në zbatim.

Para jush dëshiroj t'i shkoqis dy vlerësime për ZKA-në si më të rëndësishmet. Sipas raportit të Barometrit Ballkanik të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, ZKA-ja vazhdon të gëzojë nivel të lartë besimi publik, duke u vlerësuar pozitivisht për pavarësinë dhe rolin e saj në mbikëqyrjen e punës së qeverisë.

Shqipëria dhe Kosova renditen ndër vendet me besimin më të lartë ndaj Institucioneve Supreme të Auditimit në rajon. Raporti gjithashtu e pozicionon Kosovën në mënyrë pozitive sa i përket perceptimit për ruajtjen e pavarësisë nga ndikimet politike.

Sipas Raportit e progresit për vendin 2025, të publikuar nga Komisioni Evropian, ZKA-ja ka arritur progres të rëndësishëm në forcimin e auditimit të jashtëm, rritjen e cilësisë së auditimit dhe avancimin e transparencës dhe llogaridhënies publike në Kosovë.

Gjatë vitit 2025, ZKA-ja është përballur me disa sfida që kanë ndikuar në funksionimin dhe zhvillimin e saj institucional. Një ndër sfidat kryesore vazhdon të mbetet mungesa e një objekti adekuat për akomodimin e personelit të ZKA-së. Edhe pse Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike ka marrë vendim për ndarjen e një objekti për këtë institucion, deri më tani nuk janë ndërmarrë hapa konkret për përgatitjen dhe përshtatjen e tij për shfrytëzim nga ZKA-ja. Si pasojë, institucioni vazhdon të operojë në hapësira të marra me qira, gjë që përbën edhe kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Një sfidë tjetër ka të bëjë me mos ndryshimin e Ligjit aktual për AP dhe ZKA, në mënyrë që të adresohet përshtatja me standardet ndërkombëtare për auditim, mundësisë që kapaciteti auditues të mund të orientohet në auditime me fusha më me rrezik, materiale dhe më interes publik.

Sa për informimin tuaj, të gjitha detajet e RVP dhe punës sonë audituese i gjeni në web faqen e ZKA-së.

## **Të nderuara Media,**

Në vijim po shpalosim Planin Vjetor Auditues 2025/26

Zyra Kombëtare e Auditimit, në tetor të vitit 2025 ka filluar sezonin e ri auditues në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit për sezonin auditues 2025-2026.

Në këtë sezonë audituese, janë planifikuar 145 auditime, prej të cilave:

- ✓ 88 auditimet e detyrueshme të rregullsisë;
- ✓ 10 auditime të pajtueshmërisë;

- ✓ 3 auditime të pajtueshmërisë në vazhdim nga viti paraprak;
- ✓ 12 auditime të Ndërmarrjeve Publike;
- ✓ 3 auditime me informata të klasifikuara;
- ✓ 20 auditime të performancës;
- ✓ 3 auditime të performancës në vazhdim nga viti paraprak;
- ✓ 6 auditime të projekteve të financuara nga Banka Botërore.

Dëshiroj të ritheksoj se raportet individuale për auditimet e rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) do të finalizohen/publikohen deri më 30 qershor 2026, si dhe në përputhje me afatin ligjor, përderisa Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit 2026.

### **Raportet e Publikuara (Janar-Maj 2026) dhe rezultatet e auditimit për këtë sezone**

Ju njoftoj se deri më sot, kemi publikuar 24 raporte të auditimit, prej tyre 22 raporte të auditimit financiar dhe pajtueshmërisë, prej të cilave, 14 të Organizatave Buxhetore dhe 8 ndërmarrje publike, një auditim të performancës dhe një auditim të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta:

1. MAPL,
2. Autoriteti i Aviacionit Civil,
3. Institucioni i Avokatit të Popullit,
4. Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar,
5. Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit,
6. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës,
7. Agjencia e shërbimeve të Navigacionit Ajror,
8. Komisioni i Pavarur për Media,
9. Komuna e Istogut,
10. Komuna e Gjilanit,
11. Komuna e Graçanicës,
12. Komuna e Lipjanit
13. Komuna e Shtimes,
14. Radio Televizioni i Kosovës.

Auditimet e 8 (tetë) Ndërmarrjeve Publike të publikuar, janë:

1. Ndërmarrja Publike "KOSTT,
2. KRM "Pastërtia" Sh.A.,
3. KRU "Prishtina" Sh.A.,
4. NP "Termokos",
5. KRU "Hidrodrini" Sh.A.,
6. KRM "Uniteti" Sh.A Mitrovicë,
7. Stacioni i Autobusëve Sh.A. Prishtinë.
8. NPH „Ibër Lepenci”.

### **Auditimi i performancës -**

Menaxhimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga Komuna e Prishtinës dhe KRM „Pastrimi, si dhe

Auditim i veçantë: “Raporti i auditimit për raportin financiar vjetor të Korporatës Energjetike të Kosovës për qëllime të veçanta mbi rentën minerare të paguar për licencat për vitin 2025.

Sot para jush do të prezantoj rezultatet e këtyre raporteve të auditimit, të cilat janë publikuar dhe të njëjtat janë dërguar edhe në entitetet e audituara dhe në Kuvend.

Për 14 auditimet financiare dhe pajtueshmërisë kemi dhënë 6 opinione të pa modifikuara përkatësisht pozitive për Institucionet si: AAC, IAP, ARSHU, KPM, ASHAK dhe RTK-në. Ndërsa 8 Institucione kanë opinionin e modifikuar përkatësisht të kualifikuar (jo të mira) si: MAPL, AMIK, Gjilani, Graqanica, Shtimja, Istogu, Lipjani dhe ASHNA.

Opinionet jo të mira për këto Institucione janë dhënë për arsye se janë gjetur keqdeklarime materiale që ndërlidhen me raportimin jo të plotë dhe të saktë të pasurive, llogarive të arkëtueshme, keqklasifikimin e shpenzimeve e të cilat në masë të konsiderueshme në komuna ndërlidhen me vendime gjyqësore si rezultat i marrëveshjes kolektive.

Ndërsa, për 8 ndërmarrjet publike të përfunduara, kemi dhënë 4 opinione të modifikuara përkatësisht të kundërta; (KRU-Hidrodrini Sh.a, KRM-Uniteti Sh.a, KRM-Pastertia Sh.a, dhe Stacionit të Autobusëve Sh.a) dhe 4 opinione të kualifikuara (KOSTT-Sh.a, KRU-Prishtina Sh.a, NPH Iber Lepenci Sh.a dhe Termokos Sh.a).

Opinionet jo të mira edhe për këto ndërmarrje janë dhënë për arsye se janë gjetur keqdeklarime materiale që ndërlidhen me: raportimin jo të plotë dhe të saktë të pasurive, llogarive të arkëtueshme, mos shpalesje të detyrimeve kontigjente dhe shpalesje jo adekuate të informacioneve, nënvlerësim apo mbivlerësim të zërave të caktuar në pasqyra financiare, etj. Fakti që 8 nga 10 ndërmarrje të audituara kanë marrë opinion negativ tregon që këto ndërmarrje ende nuk kanë arritur të vendosin kontrolle adekuate për raportim financiar. Deri me 30 qershor pritet të publikohet edhe raporti i auditimit për KEK dhe Trepçën.

Nga auditimet e publikuara deri me tani rezulton se edhe kryerja e aktiviteteve, transaksioneve dhe operacioneve tjera ende nuk është në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore dhe procedurat që ndërlidhen me menaxhimin dhe shpenzimin e parasë publike.

### **Disa nga çështjet kryesore që janë identifikuar po i përmendi në vijim:**

- ✓ Mangësi në procedurat e prokurimit publik përkatësisht vlerësimin e ofertave, shpërblimi me kontratë i OE pa i plotësuar kriteret në dosjen e tenderit, përdorimi i referencave ndaj një marke brendi të caktuar pa përdorimin e shprehjes ekuivalent;
- ✓ Mangësi në përgatitjen e para masës në projektet kapitale;
- ✓ Mos zbatimi i procedurave të prokurimit publik me rastin e angazhimit të punonjësve për shërbime të veçanta;
- ✓ Ndryshime të ndarjeve buxhetore për projekte kapitale pa miratim të Kuvendit Komunal;
- ✓ Lidhja e 6 kontratave në vlerë prej 50 mijë euro për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese nga mediat portalet pa procedura të prokurimit publik;
- ✓ Vonesa në implementimin e projekteve kapitale dhe mos zbatimin e

- ndëshkimeve për vonesa;
- ✓ Mos pagesa e faturave/obligimeve ndaj operatorëve ekonomik brenda afatit ligjor;
  - ✓ Mungesa e monitorimit të subvencioneve të dhëna në fushën e bujqësisë;
  - ✓ Përzgjedhja e OJQ-ve në kundërshtim me kriteret në Thirrjen Publike
  - ✓ Angazhimi i shërbimeve të auditimit nga auditori privat, për kundër faktit se ndërmarrja ishte subjekt i auditimit nga ZKA;
  - ✓ Mos përditësimi i kontratave të të punësuarve, bazuar në vendimet e Bordit, për rritjen e pagës dhe vlerën e saktë të shujtës;
  - ✓ Mbajtja e pozitave të rregullta me ushtrues detyre përtej afatit ligjor
  - ✓ Mos menaxhimi i kontratave përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi);
  - ✓ Mos hartimi dhe përditësimi i rregulloreve sipas kërkesave ligjore për afarizmin e ndërmarrjes.

Këto janë vetëm disa prej mangësive të identifikuara në raportet që i kemi publikuar deri më tani dhe kjo tregon për nivelin jo të duhur të llogaridhënies dhe transparencës së organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike në shpenzimin e parasë publike.

## **Të nderuara media**

### **Auditimi “Efikasiteti dhe efektiviteti i grumbullimit të mbeturinave të amvisërisë në kryeqytet”**

Për shkak të interesit publik dhe gjendjes së krijuar në Komunën e Prishtinës lidhur me menaxhimin e mbeturinave, ZKA-ja ka kryer auditimin e performances “Efikasiteti dhe efektiviteti i grumbullimit të mbeturinave të amvisërisë në kryeqytet”. Raporti është dërguar sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe tek palët e audituara dhe i njëjti do të publikohet nesër në faqen zyrtare të ZKA-së. Për njoftimin tuaj, tani po i shpalojmë rezultatet kryesore të këtij auditimi.

Objektivi i këtij auditimi ishte të vlerësojmë nëse Komuna e Prishtinës dhe KRM “Pastrimi” ishin efikas dhe efektivë në ofrimin e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave në kryeqytet, duke shqyrtuar nëse shërbimi

është ofruar në mënyrë të rregullt dhe me përdorim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe materiale.

Periodha e vlerësimit të këtyre shërbimeve ka përfshirë vitin 2023- 2025.

Me theks ky auditim ka vlerësuar nëse proceset e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të shërbimit janë të strukturuar mirë dhe përmbushin nevojat e qytetarëve, ku kemi identifikuar boshllëqet, sfidat dhe mundësitë për përmirësim.

**Rezultatet e auditimit kanë treguar se Komuna nuk ka arritur të jetë efikase as efektive në grumbullimin e mbeturinave gjatë viteve të fundit.** Situata e rënduar e mbeturinave në kryeqytet, e reflektuar përmes mbingarkimit të kontenierëve dhe shpërndarjes së mbeturinave nëpër trotuare dhe hapësira publike, ka paraqitur dëshmi të dukshme dhe lehtësisht të verifikueshme edhe nga vet qytetarët.

Një nga gjetjet më shqetësuese të raportit është dështimi i pothuajse të gjitha hallkave të mbikëqyrjes institucionale. Ky proces kishte dështuar të realizohej pothuajse në të gjitha nivelet nga të gjitha palët. Disa nga shkaqet që i kanë kontribuar kësaj gjendjeje janë:

- Bordi i Drejtorëve të KRM “Pastrimi”, që është përgjegjës për vendimet strategjike dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv, nuk ka ushtruar mbikëqyrje efektive mbi veprimtarinë e KRM-së, sepse në takimet e Bordit nuk ishte trajtuar pothuajse asnjëherë problematika aktuale e mbeturinave në qytet. Në vend të kësaj Bordi ishte marrë me çështje tjera si çështje financiare dhe administrative.
- Komisioni Komunal i Aksionarëve i KRM “Pastrimi” nuk ka ushtruar mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi veprimtarinë e Bordit të Drejtorëve dhe të Ndërmarrjes Publike. Në Kuvendin vjetor të vitit 2024 Aksionarët nga Komuna e Prishtinës nuk kishin marrë pjesë. Ndërsa Kuvendi Vjetor i Aksionarëve i vitit 2025 nuk u mbajt për shkak të mungesës së kuorumit. Asnjë nga tre aksionarët e Komunës së Prishtinës nuk kishin marrë pjesë në Kuvend.

- Planet e Biznesit të KRM “Pastrimi” ngjasojnë më shumë me strategji se sa plane konkrete të biznesit. Objektivat në këto plane nuk janë të qarta, konkrete, të matshme apo të përcaktuara në kohë, rrjedhimisht nuk i përmbushin kriteret e objektivave SMART. Si të tilla nuk i kanë shërbyer Bordit të Drejtorëve si instrumente efektive për kontroll, mbikëqyrje dhe kërkim llogaridhënie.

### **Menaxhimi joefikas i Flotës dhe Operativës**

- Në raportet mujore mbi shfrytëzimin e kamionëve për periudhën 2023-2025, për shumicën e kamionëve figuron se kilometrat e përshkruar janë zero “0”, ndërkohë që për të njëjtët kamionë janë raportuar sasi të bartura të mbeturinave dhe shpenzime për karburant. Mungesa e mirëmbajtjes së pajisjeve matëse të kilometrave dhe vjetërsia e kamionëve është shkaku kryesor që këta matës janë jo funksional.
- Sipas planit operativ, në kryeqytet nevojiten deri në 31 kamionë aktivë në ditë për të mbuluar tërë territorin. Megjithatë, numri i kamionëve në dispozicion ka rënë vazhdimisht: nga 28 në vitin 2023, në 25 në vitin 2024. Në muajin tetor 2025, nga 31 kamionë sa i ka kompani, 18 prej tyre ishin në proces rregullimi. Kjo ka ndodhur për shkak të dështimit të KRM për të realizuar planet investive për zëvendësimin e kamionëve.
- Në vitin 2024, Komuna e Prishtinës ka blerë 8 kamionë të rinj për KRM “Pastrimi” (të shpërndarë në fillim të vitit 2025), ndërsa vet KRM “Pastrimi” gjatë vitit 2025 ka blerë 10 kamionë të përdorur në vlerë mbi 340 mijë euro (prej të cilëve vetëm gjashtë janë për grumbullimin e mbeturinave të amvisërisë). Pavarësisht këtyre investimeve, situata operative nuk është përmirësuar në mënyrë të dukshme. Në nëntor 2025 Kompania ka deklaruar se aktualisht janë funksional vetëm 10 – 11 kamionë dhe se nuk mund të garantojë ofrimin e shërbimit 24-orësh.
- Edhe pse Komuna bleu 8 kamionë të rinj në vitin 2024, ata u dorëzuan me vonesë. Gjashtë kamionë janë dorëzuar me 20 ditë vonesë nga data

e nënshkrimit të marrëveshjes, ndërsa dy kamionët e tjerë, ndonëse të pranuar njëkohësisht me të tjerët, janë vënë në shfrytëzim të KRM Pastrimi gjashtë muaj pas blerjes.

- Me rastin e kontraktimit të operatorëve privat për ofrimin e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave, Komuna ka vënë në funksion sistemin GPS për monitorimin e lëvizjes së kamionëve, por të dhënat nuk janë ruajtuar as nuk janë regjistruar. Ndërsa Gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes me KRM Pastrimi nuk ka qenë funksional asnjë mekanizëm për monitorim të vazhdueshëm (24 orë) të flotës së kamionëve deri në vitin 2025.

### **Gjendja me Kontenierët**

- Komuna kishte lidhur dy kontrata brenda vitit 2024 për furnizim me kontejnerë në vlerë afër 747 mijë euro, të dedikuar për KRM Pastrimi. Deri në tetor 2025 në KRM Pastrimi janë pranuar gjithsej 2,883 kontenierë nga gjithsej 3,840 sa ishin blerë. Për momentin janë afër **900 kontejnerë dhe shporta të cilat ende nuk janë shpërndarë** nëpër pika të grumbullimit të mbeturinave dhe vazhdojnë të qëndrojnë të papërdorur (në Qendrën e Kompostimit).
- Në shumë pika të grumbullimit vërehen kontejnerë të dëmtuar të cilët janë jashtë funksionit. Këta kontenier nuk largohen dhe nuk zëvendësohen me të rinj. Dëmtimi i këtyre kontenierëve shpesh ka ndodhur nga pakujdesia dhe mungesa e njohurive të stafit gjatë zbrazjes. Stafi operativ nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme për përdorimin dhe zbrazjen e kontenierëve duke shkaktuar dëmtime të shpeshta.

### **Performanca Financiare dhe Arkëtimi**

- Komuna e Prishtinës kishte faturuar në vitin 2023 dhe 2024 rreth 75,000 amvisëri. Ky numër nuk përputhet me numrin amvisërive që kishte identifikuar dhe regjistruar KRM-ja, sepse është më i vogël për afër 16 mijë njësi banimi. KRM Pastrimi llogaritet të ketë arkëtuar më pak të

hyra 1.1 milion euro ne vit për shkak të mospërfshirjes së njësive të reja në regjistra.

- Kur Komuna e bënte faturimin, shkalla e arkëtimit ishte rreth 60%. Mirëpo, në vitin 2025, kur kjo përgjegjësi i kaloi KRM "Pastrimit", kjo e fundit kishte faturuar 5,99 milionë euro, ndërsa kishte arritur të arkëtoj afër 1.29 milion euro ose vetëm 21% të faturimit. Kjo erdhi si pasojë e një deklaratë në media e Kryetarit të Komunës se Komuna ishte ende përgjegjëse për faturim dhe arkëtim, gjë që kishte shkaktuar konfuzion tek qytetarët.
- Të hyrat e realizuara nga KRM "Pastrimi" ishin të mjaftueshme për të mbuluar vetëm kostot operative, si pagat e punëtorëve që përbëjnë 66% të totalit të kostove. Për pasojë gjatë këtyre dy viteve nuk kishe bërë investime kapitale.

### **Angazhimi i Operatorëve Privatë i ka kushtuar Komunës më shtrenjtë**

- Deri në vitin 2024, KRM Pastrimi ishte e vetmja kompani përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave në Kryeqytet. Në prill të vitit 2024 Komuna angazhoi operator privat për grumbullim të mbeturinave, krahas KRM "Pastrimi".
- Operatori privat ishte më i kushtueshëm me **rreth 10 euro/ton krahasuar me Kompaninë Publike**, duke rritur kostot e Komunës për grumbullim të mbeturinave për 149 mijë euro, për periudhën prill-dhjetor 2024. Çmimi ka rezultuar **61.88 euro/ton për KRM "Pastrimi"** ndërsa **71.15 euro/ton për OE privat**.
- Pavarësisht kontraktimit të OE-ve privat, Komuna **nuk kishte arritur të bëjë përmirësime të dukshme** sa i përket grumbullimit të mbeturinave në kryeqytet.

Për informimin tuaj, Komuna e Prishtinës nuk ka kthyer përgjigje lidhur me konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit ndërsa KRM "Pastrimi" është pajtuar me konkluzionet dhe rekomandimet tona.

Komuna dhe Kuvendi Komunal duhet të emërojnë vetëm zyrtarë të përgjegjshëm dhe me integritet në strukturat e llogaridhënies për të kryer detyrat me kompetencë. Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme ndaj çdo zyrtari në raste të performancës së dobët apo moszbatimit të detyrimeve të besuara. Ky hap synon forcimin e kontrollit institucional që ka dështuar në të gjitha nivelet e mbikëqyrjes.

Së dyti, KRM "Pastrimi" duhet të rrisë efikasitetin operativ duke hartuar plane biznesi SMART dhe duke përditësuar itineraret sipas nevojave reale në terren. Është e domosdoshme zbatimi i mirëmbajtjes preventive për kamionët dhe analizimi i çdo investimi të ri kundrejt objektivave konkrete të performancës. Gjithashtu, stafi operativ duhet të kalojë nëpër programe të strukturuar trajnimi për përdorimin e saktë dhe të sigurt të kontenierëve.

Së treti, për të siguruar monitorim efektiv, Komuna duhet të instalojë sistemin GPS në të gjithë flotën e kamionëve dhe të caktojë personel të dedikuar vetëm për mbikëqyrjen e lëvizjeve të tyre. Planifikimi për furnizim dhe vendosje të kontenierëve duhet të bazohet në analiza të strukturuar që marrin parasysh fluksin e mbeturinave dhe numrin e njërive të banimit për çdo pikë grumbullimi, në vend të veprimeve ad-hoc.

Së fundi, kërkohet përmirësimi i mekanizmave të kontrollit financiar dhe arkëtimi i plotë i faturave për të garantuar qëndrueshmërinë e kompanisë. Para çdo kontraktimi të operatorëve privatë, Komuna duhet të kryejë një analizë të hollësishme krahasuese të kostos që përfshin të gjitha komponentët e çmimit. Kjo do të parandalonte shpenzimet më të larta për shërbime të njëjta, siç është vërejtur në periudhat e kaluara.

### **Bashkëpunimi i ZKA-së me prokurorin e shtetit**

Në përputhje me Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe konform Marrëveshjes për Bashkëpunim ndërmjet ZKA-së dhe Prokurorisë së Shtetit, Departamenti për Çështje Juridike dhe Kundër Mashtrimit në kuadër të ZKA-së, gjatë vitit 2025, ka dërguar 80 raste në Prokurorinë e Shtetit.

Raportet të cilat janë publikuar dhe ato të cilat pritet të publikohen do t'i nënshtrohen analizave dhe vlerësimit për të identifikuar çështjet që mund të

kenë elemente potenciale të mashtrimit apo keqpërdorimit dhe ato për të cilat dyshohet do të dërgohen në Prokurorinë e Shtetit.

Për dijeninë tuaj, më duhet të theksoj se marrëveshja ndërmjet ZKA-së dhe Prokurorisë së Shtetit parasheh që Prokuroria të ofroj për ZKA-në informata kthyesë lidhur me statusin e rasteve të cilat në baza vjetore i dërgojmë.

Sidoqoftë, ju informoj se informatat e fundit kthyesë lidhur me rastet e dërguara i kemi pranuar vetëm në prill të vitit 2024 dhe atë vetëm për 143 raste nga rreth 500 raste të adresuara nga viti 2018-2025.

Në përmbyllje, dëshiroj të theksoj se organizatat buxhetore, rekomandimet e ZKA-së duhet t'i pranojnë si një kontribut serioz më qëllim kryesor përmirësimin e proceseve, aktiviteteve dhe operacioneve të organizatave të tyre. Kjo padyshim se do të ndikojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit më të mirë të parasë publike dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me mandatin e përcaktuar kushtetues dhe ligjor do të jetë e gatshëm të ndihmojmë në adresimin sa më efikas të rekomandimeve të dhëna në të mirë të interesit publik.

Ju falënderoj për prezencën tuaj dhe bashkëpunimin e deritanishëm me ju!